



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 27 Maj 2022

Nr: 17

VENDIM

PËR

**PRANIMIN PËR SHOYRTIM TË KËRKESËS NR. 01, DATË 23.05.2022 TË
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE PËR VENDOSJE SANKSIONI
ADMINISTRATIV**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 27.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan RUSMALI - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Vendosja e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, candidate për kryetare bashkie në zgjedhjet për krytarin e bashkisë Lushnjë, të datës 06 Mars 2022

BAZË LIGJORE: Shkonja “d”, pika 1, nenit 21 i “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe shkronja “b”, neni 34 dhe neni 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 21 të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator në KQZ, ka paraqitur pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore nr. 01, datë 23.05.2022, për vendosje sanksioni administrativ ndaj kandidates për kryetar të bashkisë dhe njëkohësisht kryetare e bashkisë Lushnjë zj. Eriselda Sefa, referuar vendimit nr. 168, datë 19.05.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (si vijon KSHZ).

Në seancën e vlerësimit paraprak të datës 27.05.2022, ora 10:45, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa nr. 01, datë 23.05.2022 e KSHZ i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator në KQZ.

Pas vlerësimit paraprakisht të kriterëve të përcaktuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor, rezulton se KSHZ legjitimohet në kërkimin e tij, KAS ka kompetencën lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e kërkesës në fjalë e cili është paraqitur brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Në këtë kontekst, në mbështetje të nenit 40 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, propozohet kalimi për shqyrtim i kërkesës së KSHZ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “d” dhe nenit 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 01, datë 23.05.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, candidate për kryetare bashkie në zgjedhjet për krytarin e bashkisë Lushnjë, të datës 06 Mars 2022



2. Seanca për shqyrtimin e kërkesës do të zhvillohet në datën 31.05.2022, në orën 11:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar